



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
URDHRI I INFERMIERIT TË SHQIPËRISË

STATUTI

I URDHRIT TË INFERMIERIT NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË

TIRANË 2023

KREU I

PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i Statutit

Ky Statut ka për objekt përcaktimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të Urdhrit, të strukturave përbërëse të tij; veprimtaritë e të gjitha organeve drejtuese, zgjedhjen apo emërimin e tyre, nivelet e delegimit të kompetencave nga autoritetet drejtuese, detyrimet dhe të drejtat e anëtarëve, si dhe çështje të tjera që rregullojnë veprimtarinë e Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë.

Neni 2

Baza Ligjore

Ky statut bazohet në Ligjin Nr. 9718 datë 19.04.2007 “Për Urdhrin e Infermierit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në Ligjin Nr. 10 462 datë 13.09.2011 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 3

Personaliteti Juridik

Urdhri i Infermierit të Shqipërisë është ent publik jo buxhetor, i njohur me ligj si i tillë. Urdhri i Infermierit të Shqipërisë përdor akronimin UISH. Ai organizohet dhe funksionon në përputhje me legjislacionin në fuqi për profesionet e rregulluara, për Urdhrin e Infermierit, si edhe me rregullat e parashikuara në këtë Statut dhe në rregulloret e tij.

Neni 4

Vizioni

Urdhri i Infermierit është person juridik i pavarur, profesional, i depolitizuar, i hapur për të gjithë anëtarë, pavarësisht nga përkatësitë e tyre racore, etnike, fetare apo politike i angazhuar në rritjen e tyre profesionale si dhe të cilësisë së kujdesit shëndetësor të ofruar.

Neni 5

Misioni

Urdhri i Infermierit ka si mision ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të standardeve të miratuara nga Ministri i Shëndetësisë në ushtrimin e profesioneve infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie, logopedist/e, nëpërmjet mbikëqyrjes së normave të Kodit Etik-Deontologjik, si dhe mbrojtjes së pacientëve dhe të publikut nga kequshtrimi i këtyre profesioneve.

Neni 6

Zhvillimi i Veprimtarisë

1. Urdhri i Infermierit nëpërmjet organeve të tij:
 - a) Kryen regjistrimin e infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie dhe logopedist/e në regjistrin përkatës të këtij Urdhri;
 - b) Mbikëqyr zbatimin e detyrave profesionale, në përputhje me kërkesat e shkencave mjekësore, rregullat e etikës dhe Kodin Etik-Deontologjik;
 - c) Siguron udhëheqjen etiko-morale e deontologjike të bashkësisë së infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie dhe logopedist/e, pavarësinë e ushtrimit të profesionit dhe mbron interesat morale të këtij profesioni;
 - d) Mbron interesat e pacientëve dhe të publikut nga kequshtrimi i mjekësisë dhe shkelja e Kodit Deontologjik Mjekësor nga ana e infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie dhe logopedist/e;
 - e) Bashkëpunon për zhvillimin e standardeve profesionale, për planifikimin, hartimin dhe zhvillimin e programeve të formimit profesional;
 - f) Realizimin e trajnimeve të ndryshme në fushën e edukimit në vazhdim të infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie dhe logopedist/e;
 - g) Konfirmon anëtarësinë në Urdhrin e Infermierit, nëpërmjet dhënies dhe ridhënies së Lejës së Ushtrimit të Profesioneve.
 - h) Garanton që anëtarë e Urdhrit të përmbushin detyrimet e programit të ricertifikimit, të vendosur nga institucioni përkatës.

Neni 7

Stema dhe vula

Stema e Urdhrit të Infermierit miratohet nga Këshilli Kombëtar dhe vendoset në zyrat qendrore dhe rajonale të Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë.

Këshilli Kombëtar dhe Këshillat Rajonale kanë vulat përkatëse.

Neni 8

Selia

Selia e Këshillit Kombëtar është në Tiranë.

KREU II

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI

Neni 9

Organet kryesore

Urdhri i Infermierit të Shqipërisë është i organizuar në nivel kombëtar dhe atë rajonal.

1. Organet kryesore të Urdhrit të Infermierit në nivel kombëtar janë:
 - a) Asambleja e Përgjithshme
 - b) Këshilli Kombëtar
 - c) Presidenti i Urdhrit
 - d) Bordi Drejtues
 - e) Komisionet disiplinore.
2. Organet kryesore të Urdhrit të Infermierit në nivel rajonal janë:
 - a) Asambleja Rajonale
 - b) Këshilli Rajonal
 - c) Presidenti
 - d) Komisionet Disiplinore.

Përbërja e organeve të pikës 1 dhe 2 bëhet duke siguruar përfaqësimin gjinor në masën 30% për çdo gjini.

Neni 10

Asambleja Kombëtare

Asambleja Kombëtare përbëhet nga tërësia e anëtarëve të Këshillave Rajonalë.
Asambleja Kombëtare zgjedh pesë anëtarët e saj të Këshillit Kombëtar.
Zgjedhjet për anëtarë të Këshillit Kombëtar bëhen çdo 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.
Mbledhja e Asamblesë thirret nga Presidenti si dhe kur kërkohet nga 2/3 e Këshillit Kombëtar.

Neni 11

Këshilli Kombëtar

1. Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Infermierit përbëhet nga jo më shumë se 25 anëtarë, si më poshtë:
 - a) Presidenti i Urdhrit të Infermierit;
 - b) Zëvendëspresidenti;
 - c) Presidentët e Këshillave Rajonale;
 - d) Një përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë;
 - e) Një përfaqësues i shkollave të larta të infermierisë;
 - f) Një përfaqësues i Fondit të Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor;
 - g) Dy përfaqësues të Shoqatës së Pacientëve;
 - h) Një përfaqësues i Sindikatës së Infermierëve;
 - i) Pesë anëtarë të zgjedhur nga Asambleja Kombëtare, sipas qarqeve me numër popullsie më të madhe, përcaktuar nga Këshilli Kombëtar.
2. Rastet e shkarkimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar parashikohen në këtë Statut.
3. Këshilli Kombëtar mbledhet, si rregull jo më pak se katër herë në vit, dhe sa herë që gjykohet e nevojshme. Mbledhjet thirren nga Presidenti, ose nga Zëvendësi i tij, në mungesë të tij.
4. Vendimet e Këshillit Kombëtar merren me shumicë votash, kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.

Neni 12

Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Kombëtar

1. Këshilli Kombëtar miraton Statutin dhe Kodin Etik-Deontologjik të profesioneve infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie, logopedist/e, rregulloret e funksionimit të këshillave dhe të organizmave vartëse.
2. Këshilli Kombëtar përcakton strukturën organizative të Urdhrit të Infermierit në nivel kombëtar dhe rajonal.
3. Këshilli Kombëtar miraton buxhetin dhe administrimin e pasurive të Urdhrit të Infermierit në nivel kombëtar.
4. Këshilli Kombëtar zgjedh Presidentin dhe zëvendësin e tij.
5. Këshilli Kombëtar emëron dhe shkarkon Sekretarin e Përgjithshëm.
6. Këshilli Kombëtar miraton pagat, kuotizacionet, kuotat e honorareve, tarifat e regjistrimit, të liçencimit dhe riliçencimit si dhe shpenzimet për veprimtari të tjera edukative dhe promovuese.
7. Këshilli Kombëtar drejton dhe mbikëqyr veprimtaritë e Këshillave Rajonale.
8. Këshilli Kombëtar përfaqëson dhe mbron interesat e përbashkëta të profesioneve infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie, logopedist/e ndaj shkeljeve të të drejtave të ushtrimit legjitim të profesionit të tyre.

9. Këshilli Kombëtar miraton veprimtaritë kombëtare për njohjen e bashkësisë së infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie, logopedist/e me aktet normative, misionin, synimet, funksionet dhe detyrat e Urdhrit të Infermierit.
10. Këshilli Kombëtar informon opinionin për misionin e Urdhrit të Infermierit si dhe deklaron qëndrimet e tij për situata të veçanta shëndetësore me interes publik.
11. Këshilli Kombëtar organizon dhe mbikëqyr procesin e regjistrimit dhe përditësimit të Regjistrit të profesioneve infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie, logopedist/e në nivel kombëtar;
12. Këshilli Kombëtar organizon dhe mbikëqyr punën për liçensimin e profesioneve infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie, logopedist/e.
13. Këshilli Kombëtar koordinon bashkëpunimin dhe bashkëveprimin me organizmat përkatëse për ruajtjen e standardeve të larta në përgatitjen e profesioneve infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie, logopedist/e, në ushtrimin e profesionit si dhe për kualifikimin e vazhdueshëm të tyre.
14. Këshilli Kombëtar zgjedh Komisionin Disiplinor Kombëtar dhe komisionet e tjera të përhershme dhe kontrollojnë periodikisht veprimtaritë e tyre.
15. Këshilli Kombëtar organizon bashkëpunimin me organizma të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare të vendit dhe të huaja.
16. Këshilli Kombëtar organizon kualifikimin e pjestarëve të strukturave të Urdhrit të Infermierit si dhe formimin e vazhdueshëm të gjithë profesionistëve nëpërmjet trajnimeve të ndryshme (seminare, konferenca), botimit të literaturës profesionale dhe të faqes së internetit.
17. Këshilli Kombëtar bashkëpunon me Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucionet e linjës së saj për hartimin e projekt-ligjeve dhe të akteve të tjera që lidhen me fushën e veprimtarisë të UISH.
18. Këshilli Kombëtar propozon dekorime për personat që japin kontribut të veçantë në profesionet e tyre në kuadrin e Urdhrit të Infermierit.
19. Këshilli Kombëtar mban lidhje dhe marrëdhënie me organizma analoge të huaja dhe miraton marrëveshje dhe protokolle bashkëpunimi me to.
20. Këshilli Kombëtar shpall dhe organizon Zgjedhjet në Organet e UISH-së në përfundim të mandatit ose ato të jashtëzakonshme ose të pjesshme në rast nevojë.

Neni 13

Kriteret për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar

Anëtarë të Këshillit Kombëtar zgjidhen infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie, logopedist/e më të aftë profesionalisht, bazuar në këto kriterë:

1. Të jenë shtetas shqiptarë.
2. Të kenë mbi 5 vjet të regjistruar në Urdhrin e Infermierit, me Leje aktive pa shkëputje nga UISH.
3. Të kenë shfaqur korrektësi në zbatimin e normave, ligjeve dhe rregullave të jetës shoqërore si dhe në komunikimin me publikun, pacientët, kolegët dhe me drejtuesit.

4. Aktivizimi në veprimtari studimore, grada, titulli shkencor, veprimtaria pedagogjike dhe veprimtari publikuese shëndetësore përbëjnë përparësi.
5. Të ketë pjesëmarrje sa më aktive në veprimtari social-shëndetësore me bashkësinë e infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie, logopedist/e.
6. Të mos ketë kryer vepra penale si dhe gjatë 5 vjetëve të fundit të mos jetë ndëshkuar për shkelje të ushtrimit të profesionit.

Neni 14

Mbarimi i mandatit të anëtarit të Këshillit Kombëtar

Anëtari i Këshillit Kombëtar dhe atij Rajonal largohet para kohe nga Këshilli kur:

1. Humbet jetën;
2. Dorëhiqet;
3. Paaftësohet për arsye shëndetësore;
4. Dënohet me vendim të formës së prerë për vepra penale apo për shkelje në ushtrim të profesionit ose shkelje administrativo-disiplinore;
5. Mungon 3 herë në mbledhjet e Këshillit pa shkaqe të arsyetuara;
6. Emërohet apo zgjidhet në detyra drejtuese shtetërore apo partiake që bien ndesh me kriteret e parashikuara në këtë Statut.
7. Largohet me dëshirën e tij duke paraqitur kërkesën me shkrim, një muaj përpara, në Këshillin Rajonal.

Neni 15

Presidenti i Këshillit Kombëtar

1. Presidenti i Urdhrit zgjidhet me votim të fshehtë nga Këshilli Kombëtar ndërmjet jo më pak se 2 kandidaturash alternative.
2. Presidenti zgjidhet nga Këshilli Kombëtar me mandat 5-vjeçar me të drejtën e një rizgjedhjeje.
3. Funkcioni i tij është i papajtueshëm me funksione të tjera drejtuese në Administratën Shtetërore
4. Presidenti i Këshillit Kombëtar ka këto detyra e kompetenca:
 - a) Drejton dhe mbikëqyr të gjithë veprimtaritë e Urdhrit të Infermierit në fushën juridike, ekonomike e profesionale duke i raportuar e miratuar vazhdimisht në Këshillin Kombëtar.
 - b) Nxjerr urdhëra e udhëzime për mbarëvajtjen e punës, bazuar në Ligjin dhe në Statutin e Urdhrit të Infermierit.
 - c) Shqyrton dhe miraton propozimet e Bordit Drejtues.
 - d) Thërret dhe drejton mbledhjet e Asamblesë Kombëtare, Këshillit Kombëtar dhe Bordit Drejtues.
 - e) Thërret, sipas rastit, mbledhjet e asambleve apo këshillave rajonale.

- f) Përfaqëson Këshillin Kombëtar në marrëdhënie me organe dhe organizma qeveritare dhe jo qeveritare brenda dhe jashtë vendit.
 - g) Ndërmerr nisma propozimi për organet ligjvënese e vendim-marrëse për akte me rëndësi për shëndetësinë shqiptare në bashkëpunim me autoritetet përkatëse dhe veçanërisht në kuadrin e profesioneve të Urdhrit të Infermierit.
 - h) Propozon kandidatura për t'u zgjedhur ose shkarkuar në organet e Urdhrit të Infermierit si dhe për dekorime. Jep vlerësime, shpërblime, ndihma ekonomike etj, sipas propozimeve të Bordit Drejtues.
 - i) Emëron dhe shkarkon punonjësit e aparatit që nuk janë të zgjedhur.
5. Funkzioni i Presidentit të Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë është i papajtueshëm me funksione të tjera administrative, shtetërore apo politike.

Neni 16

Zv/Presidenti i Këshillit Kombëtar

Zv/Presidenti i Këshillit Kombëtar kryen detyrat e titullarit në mungesë të Presidentit si dhe mund të drejtojë sektorë të caktuar në strukturat e Urdhrit të Infermierit.

Neni 17

Bordi Drejtues i Këshillit Kombëtar të UISH

1. Bordi Drejtues është organ ekzekutiv i cili organizon, kontrollon e mbikëqyr zbatimin e vendimeve të Asamblesë Kombëtare, Këshillit Kombëtar dhe të urdhëresave dhe udhëzimeve të Presidentit të Këshillit Kombëtar.
2. Bordi Drejtues drejtohet nga Presidenti i Këshillit Kombëtar dhe përbëhet nga: dy zv/presidentët, Sekretari i Përgjithshëm, Kryetari i Degës Ekonomike-financiare.
3. Bordi Drejtues shqyrton dhe i paraqet për miratim Këshillit Kombëtar bilancin e veprimtarisë ekonomiko-financiare të Urdhrit të Infermierit , projekt buxhetin financiar të vitit pasardhës si dhe projekte për veprimtaritë e organeve të Urdhrit të Infermierit.

Neni 18

Asambleja Rajonale

1. Asambleja Rajonale përbëhet nga tërësia e përfaqësuesve të anëtarëve të Urdhrit të Infermierit të qarkut. Përfaqësuesit zgjidhen nga anëtarësia në bazë të një numri përfaqësimi të caktuar nga Këshilli Kombëtar.
2. Asambleja Rajonale zgjedh Këshillin Rajonal me 5 deri 9 anëtarë në varësi të numrit të anëtarëve të Urdhrit të Infermierit në qark. Këshilli Rajonal Tiranë përbëhet nga 13 anëtarë. Numri i prëbërjes përcakohet nga Këshilli Kombëtar. Zgjedhjet në Këshillin Rajonal bëhen çdo 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

3. Asambleja Rajonale thirret nga, Presidenti i Këshillit Kombëtar, Presidenti i Këshillit Rajonal, si dhe kur kërkohet nga 2/3 e anëtarëve të Këshillit Rajonal.

Neni 19

Presidentët Rajonalë të Urdhrit

1. Këshillat Rajonalë zgjedhin presidentët e këshillave rajonal. Mandati i tyre është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.
2. Kandidaturat për President të Urdhrit të Infermierit duhet të përmbushin këto kritere:
 - a) të jenë jo më shumë se në moshën e daljes në pension në momentin e zgjedhjes;
 - b) të kenë jo më pak se 15 vjet përvojë në profesion;
 - c) të kenë përvojë dhe të dhëna të besueshme për aftësi komunikimi, organizuese e drejtuese;
 - d) të mos kenë marrë masa ndëshkimore disiplinore në 5 vitet e fundit;
 - e) të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale.
3. Presidentët Rajonalë shpërblehen për punën e tyre në bazë të honorareve në masën e miratuar nga Këshilli Kombëtar.
4. Presidentëve Rajonalë i mbaron mandati 10 ditë pas Asamblesë Kombëtare duke dorëzuar zyrën dhe vlerat materiale të UISH-së në qark.

Neni 20

Përbërja, funksionet dhe detyrat e Këshillit Rajonal

Këshilli Rajonal krijohet sipas ndarjes administrative-territoriale në bazë qarku.

Këshilli Rajonal përbëhet nga 5-9 anëtarë, kurse Këshilli Rajonal Tiranë nga 11-13 anëtarë, si vijon:

- a) Presidenti i Këshillit rajonal të Urdhrit të Infermierit;
- b) Zv/Presidenti i Këshillit rajonal;
- c) Anëtarët e Këshillit Rajonal të zgjedhur nga Asambleja e Qarkut.

Këshilli Rajonal ka këto detyra kryesore:

1. Zgjedh me votim të fshehtë, me shumicë votash Presidentin dhe zv/Presidentin.
2. Emëron dhe shkarkon sekretarin e tij.
3. Krijon dhe përditëson Regjistrin e profesioneve infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie, logopedist/e si dhe liçensimin dhe riliçensimin e tyre dhe të shërbimeve mjekësore private të vendit e të huaja në juridiksionin e tij.
4. Organizon punën për zbatimin e vendimeve të Këshillit Kombëtar dhe të udhëzimeve të Presidentit të Urdhrit të Infermierit.
5. Punon për njohjen e bashkësisë infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie, logopedist/e me aktet normative, misionin, funksionet dhe detyrat e Urdhrit të Infermierit me veprimtari të drejtpërdrejta dhe përmes mediave;

6. Analizon në mënyrë periodike veprimtaritë e Urdhrit të Infermierit dhe të strukturave të tij në qark.
7. Mbikëqyr në mënyrë të vazhdueshme veprimtarinë e anëtarëve të vet, zbatimin e Kodit Etik-Deontologjik, nivelin e standartit të kujdesjeve, komunikimin dhe marrëdhëniet me pacientët dhe mban qëndrim sipas sanksioneve të parashikuara për çdo rast të shkeljes së tij.
8. Zgjedh Komisionin Disiplinor në bazë të kriterëve të posaçme, si dhe komisione dhe grupe të tjera pune.
9. Përfaqëson dhe mbron interesat e përbashkëta legjitime të profesioneve mjekësore dhe deklaron publikisht opinionet e tij për ngjarje e situata të veçanta në qark.
10. Organizon punën për mbledhjen e kuotave dhe të detyrimeve të tjera financiare.
11. Bashkëpunon me organizma qeveritare dhe të OJF brenda rajonit dhe vendit.
12. I propozon Këshillit Kombëtar dhe Presidentit nisma që i konsideron të rëndësishme për të rritur standardet e shërbimit në rajonin e vet ose më gjerë.
13. Merr pjesë në organizimin dhe zhvillimin e veprimtarive studimore shkencore dhe kualifikuese të profesioneve infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie, logopedist/e të rajonit dhe më gjerë.
14. I paraqet Këshillit Kombëtar ose Presidentit propozime për dekorime, vlerësime, shpërblime si dhe për ndihma në raste fatkeqësish për anëtarët e Urdhrit të Infermierit në rajon.
15. Bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me pacientët dhe shoqatat e tyre lidhur me cilësinë e kujdesjeve, vlerëson kërkesat dhe mendimet e tyre.

Neni 21

Thirrja e Këshillave Rajonalë

Këshilli Rajonal thirret në mbledhjet e tij nga Presidenti, ose në mungesë të tij, nga Zv. Presidenti. Mbledhjet e Këshillit bëhen, si rregull, jo më pak se katër herë në vit. Kur gjykohet e nevojshme thirret mbledhja e jashtëzakonshme e Këshillit, por vetëm me miratim nga Presidenti i Këshillit Kombëtar.

Neni 22

Sekretari i Përgjithshëm

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për problemet tekniko-organizative të Këshillit Kombëtar dhe të aparatit të tij. Ai mund të jetë infermier, jurist, sociolog ose ekonomist. Sekretari i Përgjithshëm kryen këto detyra:

1. Kujdeset për krijimin dhe azhornimin e Regjistrit të UISH-së, e për organizimin e drejtimin e komisioneve e grupeve të punës dhe mbikëqyr veprimtarinë e tyre.
2. Kujdeset për hartimin dhe zbatimin e Kodit Etik-Deontologjik si dhe të rregulloreve të tjera për veprimtaritë e Urdhrit të Infermierit.

3. Ndhmon, bashkërendon dhe mbikëqyr veprimtarinë e Këshillave Rajonalë.
4. Përgatit materialet dokumentare për mbledhjet e Këshillit Kombëtar, të Bordit Drejtues dhe të komisioneve e grupeve të punës.
5. Organizon punën për përgatitjen e informacioneve 6 – mujore për Ministrinë e Shëndetësisë sipas kërkesave të ligjit dhe për publikimin e tyre në faqen e internetit të Urdhrit të Infermierit.
6. Raporton dhe informon sistematikisht Presidentin dhe Këshillin Kombëtar për detyrat e caktuara.

Neni 23

Propozimi dhe vendimmarrja për largimin e parakohshëm

Për largimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar dhe Rajonal, propozimi i paraqitet Këshillit përkatës.

1. Për anëtarët e Këshillave Rajonalë:
 - Së paku 1/5 e Asamblesë Rajonale;
 - 1/3 e anëtarëve të atij këshilli;
 - Presidenti i Këshillit përkatës;
2. Për Presidentët e Këshillave Rajonalë:
 - Së paku 1/5 e Asamblesë Rajonale;
 - 1/3 e anëtarëve të këshillit përkatës;
 - Presidenti i Këshillit përkatës;
3. Për anëtarët e Këshillit Kombëtar:
 - Së paku 1/5 e Asamblesë së Përgjithshme;
 - 1/3 e anëtarëve të Këshillit Kombëtar;
 - Presidenti i Këshillit Kombëtar;
4. Për Presidentin e Këshillit Kombëtar:
 - Së paku 1/3 e Asamblesë së Përgjithshme;
 - 2/3 e anëtarëve të Këshillit Kombëtar.

Në të gjitha rastet, vendimi merret me së paku 2/3 e votave vendimore të anëtarëve të pranishëm. Votimi bëhet i fshehtë me përjashtim të rasteve kur vetë Këshilli përkatës vendos ndryshe.

Neni 24

Njoftimi përmbledhjet

Presidenti i Këshillit Kombëtar apo rajonal vendos për datën, kohën dhe rendin e ditës së çdo mbledhje. Mbledhja e Këshillit (Kombëtar apo rajonal) njoftohet me shkrim, si rregull, 5 ditë përpara, duke bërë të ditur edhe rendin e ditës.

Në çdo mbledhje duhet të jenë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të cilët paraprakisht miratojnë zhvillimin e mbledhjes.

Neni 25

Rendi i Ditës

Këshilli (Kombëtar apo rajonal) merr vendim vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes, përveç rasteve kur të paktën 2/3 e anëtarëve janë dakort për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve edhe për çështje që nuk janë në rendin e ditës.

Neni 26

Vlefshmëria e mbledhjes

Mbledhja e Këshillit (Kombëtar apo Rajonal) është e vlefshme kur janë të pranishëm të paktën 1/2 e anëtarëve.

Kur në hapjen e mbledhjes kjo shumicë nuk arrihet, atëherë Presidenti apo zëvendësi që drejton mbledhjen, vendos thirrjen e mbledhjes një ditë tjetër, duke përsëritur njoftimin me shkrim. Në këtë rast mbledhja është e vlefshme në qoftë se janë të pranishëm së paku gjysma e anëtarëve.

Neni 27

Procesverbali i mbledhjes

Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal ku shkruhet data, vendi i mbledhjes, pjesëmarrësit, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën si dhe forma e rezultati i votimit. Presidenti i Këshillit Rajonal cakton një person për mbajtjen e procesverbalit.

Në mbarim të mbledhjes procesverbali nënshkruhet nga mbajtësi (sekretari) dhe Presidenti i Këshillit ose zëvendësi që ka drejtuar mbledhjen.

Neni 28

Forma e votimit

Vendimet merren me votime të hapura përveç rasteve kur për arsye e rrethana të veçanta vendoset ndryshe.

Vendimet që përmbajnë vlerësime mbi sjelljen ose cilësitë e një individi merren vetëm me votim të fshehtë.

Neni 29

Vlefshmëria e votës për të marrë vendime

Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje, përveç rasteve kur kërkohet një shumicë e cilësuar. Kur kjo e fundit nuk arrihet, atëhere kryhet një votim i dytë. Nëse edhe në votimin e dytë situata përsëritet atëhere vendimi shtyhet në një mbledhje tjetër në të cilën është e mjaftueshme një shumicë e thjeshtë votash.

Në rastet kur votat barazohen dhe votimi është i hapur, vendos vota e Presidentit.

Neni 30

Komisionet disiplinore

1. Pranë Këshillit Kombëtar dhe Këshillave Rajonalë të Urdhrit të Infermierit funksionojnë komisionet disiplinore, të cilat caktohen nga këshillat përkatës.
2. Komisionet disiplinore janë organizma të gjykimit profesional. Ato verifikojnë dhe shqyrtojnë ankesat për shkeljet e etikës mjekësore, të Kodit Etik-Deontologjik, si dhe gabimet mjekësore nga anëtarët e Urdhrit të Infermierit, të nxjerra nga raportet e inspektorëve apo grupeve të punës, të ngritura për mbikëqyrjen e nivelit të standarteve dhe zbatimin me korrektësi të Kodit Etik-Deontologjik, si dhe nga çdo ankesë e ardhur nga pacientët.
3. Komisionet disiplinore pranë Këshillave Rajonalë ushtrojnë përgjegjësi disiplinore të shkallës së parë. Vendimet e tyre ankimohen në komisionin disiplinor të Këshillit Kombëtar, i cili ushtron kompetenca disiplinore të shkallës së dytë dhe përfundimtare.
4. Komisionet disiplinore funksionojnë në bazë të rregullores për komisionet disiplinore të miratuar nga Këshilli Kombëtar.

Neni 31

Masat disiplinore

1. Komisioni disiplinor mund të vihet në lëvizje nga një ankesë e paraqitur me shkrim apo me gojë, por ai mund të vihet në lëvizje edhe me iniciativë, ose me urdhrë të Presidentit, me propozim të Kryeinspektorit.

2. Komisioni disiplinor heton dhe gjykon, në bazë të fakteve dhe provave të administruara, në seancë dëgjimore. Kur vërteton se anëtari ka kryer shkelje të etikës mjekësore, të Kodit Etk- Deontologjik ose ka bërë gabim mjekësor, ai jep masat e mëposhtme:
 - a) vërejtje me shkrim;
 - b) vërejtje me paralajmërim;
 - c) gjobë nga 1 500 lekë deri në 100 000 lekë;
 - d) propozim për shkarkim nga funksionet drejtuese në institucione shëndetësore;
 - e) pezullim nga e drejta e zgjedhjes në organet drejtuese të Urdhrit të Infermierit deri në 3 vjet;
 - f) përjashtim i përkohshëm nga Urdhri i Infermierit për një periudhë deri në 3 vjet. Gjoha e vjelë, sipas shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 16, derdhet në Buxhetin e Shtetit.
3. Përveç masave të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, si masë plotësuese, komisioni ka të drejtë t'u caktojë të ndëshkuarve kryerjen e një rikualifikimi ose të studimeve plotësuese.
4. Masat e mësipërme disiplinore mund të shlyhen, nëse ndaj anëtarit, brenda 1 viti nga data e dhënies së tyre, për shkronjat "a" dhe "b" të këtij neni dhe brenda 3 vjetëve nga data e dhënies, për shkronjat "ç", "d" dhe "dh", nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore.

Neni 32

Komisioni i Gjyimit Profesional

Pranë Këshillave Rajonal krijohet Komisioni i Gjykimi Profesional, i përbërë nga 5 profesionistë të zgjedhur nga më të mirët dhe më korrektët nga Institucionet Shëndetësore të rajonit duke respektuar shtrirjen e rajonit të cilët mbas propozimeve të mbledhura miratohen në Këshillin Rajonal.

Për Këshillin Kombëtar krijohet një Komision Kombëtar i përbërë nga 7 persona, 4 persona të zgjedhur dhe të miratuar në Këshillin Kombëtar, 1 jurist i UISH-së, 1 anëtarë kryetar i UISH-së së rajonit ku ka ndodhur problemi dhe 1 anëtarë përfaqësues i UISH-së i Këshillit Rajonal në distriktin ose institucionin përkatës.

Komisionet e krijuara, vihen në lëvizje me një urdhër me shkrim të Presidentit Rajonal ose Kombëtar, kur ka ankimim nga pacientët apo familjarët e tyre, kur ka një raport nga inspektorët përkatës apo nga grupet e kontrollit të organizuar nga UISH ose në bashkëpunim me Institucionet e Ministrisë së Shëndetësisë.

Neni 33

Funksionimi i komisionit të gjyimit profesional :

Komisioni në takimin e parë zgjedh Kryetarin dhe Sekretarin e tij. Kryetari drejton seancën dhe firmos vendimet përfundimtare.

Sekretari mban protokollin dhe gjithë dokumentacionin e duhur, përgatit dhe firmos vendimet përfundimtare.

Fillimisht, njihet me problemin që do të gjykohet : ankesë, raport apo evidentime të ndryshme që paraqiten, më pas dëgjohet profesionisti që ka bërë shkeljen. Si e arsyeton ai atë. Çdo gjë shkruhet në procesverbal të mbajtur nga sekretari.

Për çdo rast gjykohet dhe vendoset në veçanti me shumicë votash.

Në fund hartohet vendimi përfundimtar i cili firmoset nga të gjithë anëtarët.

Vendimi hartohet në 3 kopje : (1 kopje arshivohet, 1 i jepet personit të interesuar, 1 i dërgohet Këshillit Kombëtar).

Neni 34

Sanksionet

Sanksionet që parashikohen për shkelje të neneve të Kodit Etik-Deontologjik të UISH-së janë:

1. “Për mosparaqitjen me uniformën e caktuar dhe mos mbajtje të kartës së identitetit profesional ose dalja me uniformë jashtë vendit të caktuar”, përbën shkelje të Nenit 2, pika 6 dhe 7, dënohet me vërejtje, gjobë 2 000-20 000 lekë.
2. “Për pritje dhe komunikim jo të mirë me pacientët, familjarët dhe kolegët” , përbën shkelje të Nenit 2, pika 8 dhe dënohet me gjobë, 2 000- 20 000 lekë dhe me ulje në detyrë 6 muaj – në një Vit.
3. “Mosdhënia e kujdesit të duhur dhe mos respektimi i pacientit pavarësisht moshës, ngjyrës apo nga bindjet e tij” përbëjnë shkelje të Nenit 2, pika 4 dhe dënohet me gjobë nga 3 000-30 000 lekë, ulje në detyrë ose përjashtim nga UISH nga 1-6 muaj.
4. “Kërkimi, stimulimi, ndërmjetësimi, marrja e ryshfetit në çfarëdolloj forme” , është shkelje e Nenit 2, pika 9 dhe dënohet me 5 000-100 000 lekë gjobë, me ulje në detyrë dhe me përjashtim nga UISH 6-12 muaj.
5. “Uljes së reputacionit dhe figurës morale nëpërmjet provokimit apo të përdorimit të drogës, alkoolit apo imoralitetit” , përbën shkelje të Nenit 2, pika 13 dhe dënohet me gjobë 10 000-100 000 lekë ose përjashtim nga UISH për një periudhë 1-3 vjeçare.
6. “Pakujdesia në kryerjen e detyrës, tejkalimi i kompetencave që kanë sjellë dëme serioze në shëndetin e pacientit”, përbën shkelje të Nenit 2, pika 19 dhe dënohen me përjashtim nga UISH dhe ndjekje penale.
7. “Mos trajtimi i kufomës dhe mos dërgimi i saj në morg, në mungesë të familjarëve” , përbën shkelje të Nenit 4, pika 18 dhe dënohet me gjobë 5 000-100 000 lekë dhe me përjashtim nga UISH për 3-6 muaj.
8. “Mos dhënia e ndihmës së parë në raste urgjente apo fatkeqësish natyrore në kushte të pa justifikueshme”, përbën shkelje të Nenit 2, pika 17 dhe dënohet me përjashtim nga UISH për 6-12 muaj.
9. “Shkeljet e Kodit Etik-Deontologjik dhe Statutit të UISH-së, të mos marrjes në kohë të lejes për ushtrimin e profesionit, ose mos pagimin e kuotës së caktuar, në më shumë se 6 muaj” , përbën shkelje të Nenit 1, pika 5 dhe dënohet me gjobë nga 5 000-100 000 lekë ose me përjashtim nga UISH për 6-12 muaj.

10. “Ushtrimi i profesionit pa u anëtarësuar në UISH” , përbën shkeljen e Ligjit Nr. 9718, datë 19/04/2007 dhe dënohet me gjobë 100 000 lekë, ose çohet për ndjekje penale.

Neni 35

Ankimimi

1. Ankesat kundër vendimeve për marrjen e masave disiplinore nga komisionet disiplinore, pranë Këshillave Rajonalë të Urdhrit të Infermierit paraqiten në komisionin disiplinor të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Infermierit brenda 30 ditëve nga komunikimi me shkrim i vendimit.
2. Komisioni disiplinor i Këshillit Kombëtar, brenda 30 ditëve nga marrja e ankesës, detyrohet të japë vendimin për ankesën e paraqitur. Vendimi i komisionit disiplinor të Këshillit Kombëtar është përfundimtar.
3. Kundër vendimit të komisionit disiplinor të Këshillit Kombëtar, personi ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës brenda 30 ditëve nga data e komunikimit me shkrim të vendimit.

Neni 36

Detyrimi për kualifikimin profesional

Për ruajtjen e standardeve të larta në ushtrimin e profesionit, komisionet disiplinore vendosin edhe detyrime me afate të përcaktuara, sipas veçorive të çdo rasti, për kualifikimin e nevojshëm profesional dhe të studimeve plotësuese me provimet përkatëse.

Këto detyrime bashkërendohen, mbikëqyren dhe testohen së bashku nga komisionet përkatëse të Urdhrit të Infermierit me Fakultetin e Infermierisë. Shpenzimet përkatëse për kualifikimin përballohen nga anëtari i ndëshkuar.

Neni 37

Shpenzimet për proceset disiplinore

Të gjitha shpenzimet për çdo proces disiplinor të kryera nga të gjitha strukturat fillimisht përballohen nga Urdhri i Infermierit. Kur vendimi i Gjyimit Profesional merr formë të prerë, në bazë të situacionit përfundimtar të shpenzimeve, bëhet rimbursimi i vlerës së plotë të tyre nga anëtarëi i ndëshkuar ose nga personi tjetër i caktuar në vendimin përkatës disiplinor brenda 90 ditëve. Për çdo ditë vonesë deri në 30 ditë pas mbarimit të këtij afati kohor, aplikohet 1 për qind gjobë. Nëse anëtari i ndëshkuar nuk shlyen këtë detyrim, atij i hiqet menjëherë e drejta individuale e ushtrimit të profesionit në institucion publik, privat apo si i vetëpunësuar.

Neni 38

Komisione të tjera

Pranë Këshillit Kombëtar dhe Këshillave Rajonalë, në vartësi të detyrave dhe problemeve, sipas rastit krijohen komisione të përherëshme ose të përkohëshme për:

1. Komisionin e Statutit, Mandateve dhe pranimin e kandidaturave;
2. Regjistrimin e anëtarëve dhe përditësimin e regjistrit të Urdhrit të Infermierit;
3. Liçensimin dhe riliçensimin;
4. Standardet, arsimimin dhe kualifikimin;
5. Marrëdhëniet publike dhe me jashtë;
6. Planifikimin dhe kontrollin ekonomiko-financiar;
7. Nxjerrjen e organit periodik dhe botime të tjera si dhe edukimit në vazhdim.

Veprimtaria e këtyre komisioneve bazohet në rregulloret përkatëse të cilat miratohen nga Këshilli Kombëtar.

KREU III

ANËTARËSIMI NË URDHRIN E INFERMIERIT

Neni 39

Kriteret e anëtarësimit

1. Anëtarë i UISH-së mund të jetë çdo shtetas shqiptar apo i huaj që zotëron diplomë për: infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie, logopedist/e dhe ushtron profesionin në Republikën e Shqipërisë.
2. Nëse kandidati për anëtarë i UISH-së është diplomuar jashtë vendit, ai mund të anëtarësohet vetëm pas njësimin të diplomës, nga ministria e përgjegjëse për arsimin në Republikën e Shqipërisë.
3. Shtetasi i huaj, që të ushtrojë një nga profesionet e pikës 1, në Republikën e Shqipërisë, duhet të jetë anëtarë i të njëjtit Urdhër në shtetin e origjinës ose në shtetin e fundit ku ka ushtruar profesionin.
4. Mund të jenë anëtarë të urdhrin edhe nëpunësit e administratës publike, sa kohë nuk ushtrojnë veprimtari si infermier, mami, ose fizioterapeft. Këto anëtarë përjashtohen nga detyrimi pagimit të kuotizacionit.

Neni 40

Detyrimi për anëtarësi

1. Asnjë individ nuk mund ta ushtrojë profesionin e infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie, logopedist/e në Republikën e Shqipërisë pa qënë anëtarë i Urdhrit të Infermierit.

2. Punëdhënësit e institucioneve shëndetësore, publike dhe private, të shërbimit shëndetësor parësor, dytësor dhe tretësor, ndalohen t'i punësojnë në kundërshtim me këtë dispozitë.

Neni 41

Ndalimi i ushtrimit të profesionit

Askush nuk mund të ushtrojë profesionin e infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie, logopedist/e në Republikën e Shqipërisë pa qenë anëtarë i Urdhrit të Infermierit.

Neni 42

Platforma Online

Urdhri i Infermierit të Shqipërisë ofron procesin e regjistrimit fillestar të anëtarëve, rilicensimin dhe rianëtarësimin. Dokumentat për anëtarësim do të ngarkohen në Platformën Online dhe për herë të parë duhet të dorëzohen fizikisht të noterizuara pranë zyrave përkatëse. Çdo anëtarë do të ketë llogarinë e tij në Platformën Online.

Neni 43

Dokumentet për anëtarësim

1. Profesionisti i interesuar duhet të paraqesë online këto dokumenta:
 - a) Kërkesën për anëtarësim ku shprehet se profesionisti zotohet të zbatojë Ligjin, Statutin e Urdhrit të Infermierit, Kodin Etik-Deontologjik;
 - b) Curriculum Vitae;
 - c) Fotokopje të Diplomës, Dëftesë, Dëshmi, etj, që vërtetojnë formimin e tij profesional, të noterizuara. Për shtetasit e huaj kërkohet kopje e noterizuar e Diplomës, e njehsuar nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit, sipas ligjit;
 - d) Foto digjitale 3 x 4 cm;
 - e) Fotokopje e librezës së punës, vërtetim nga vendi punës (nese ka);
 - f) Vërtetim nga ASCK për kreditet;
 - g) Çertifikata për kualifikime të ndryshme;
 - h) Mandat-arkëtimin që ka derdhur në llogarinë e UISH-së tarifën e caktuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të UISH-së.
2. Profesionistët që aktualisht ushtrojnë profesionin para datës të hyrjes në fuqi të Ligjit duhet detyrimisht të anëtarësohen në Urdhrin e Infermierit sipas kërkesave të këtij Neni.

Neni 44

Pagesa për anëtarësim

Kërkuesi paguan tarifën, e cila përcaktohet me vendim të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Infermierit për veprimet e kryera për anëtarësim e regjistrim.

Për subjektet private të vendit dhe të huaja, Këshilli Kombëtar vendos tarifa të veçanta, të cilat derdhen në numrin e llogarisë përkatëse.

Neni 45

Ankimi për refuzimin e anëtarësimit

Ndaj vendimit që refuzon kërkesën për anëtarësim e regjistrim, kërkuesi ka të drejtë të ankohet pranë Këshillit Kombëtar jo më vonë se 30 ditë nga dita e shpalljes dhe marrjes së njoftimit për vendimin.

Komisioni i Këshillit Kombëtar e shqyrton atë jo më vonë se 2 muaj nga paraqitja e ankesës dhe merr vendim i cili është i formës së prerë. Kërkuesi ka të drejtë t'i drejtohet rajonit përsëri me kërkesë vetëm 12 muaj pas përgjigjes negative nga Komisioni Kombëtar, dhe vetëm në se ka plotësuar kushtet për pranim.

Neni 46

Rianëtarësimi dhe Rilicensimi

Profesionet infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie, logopedist/e që, për arsye të ndryshme, nuk e kanë ushtruar profesionin e tyre për një periudhë mbi 7-10 vjet, do t'i nënshtrohen një rikualifikimi 3-6 muaj që të regjistrohen/ri-regjistrohen për ushtrim profesioni.

Programi dhe mënyrat përcaktohen nga organet përkatëse të Urdhërit të Infermierit.

- Rilicensimi bëhet çdo pesë vjet duke respektuar afatet e Lejës së Ushtrimit të Profesionit duke paraqitur dokumentet e kërkuara dhe tarifën e përcaktuar me vendim të Këshillit Kombëtar.
- Kur rinovimi i Lejes kalon afatin dhe profesionisti e ushtron profesionin deri në një vit i nënshtrohet Gjykimit Profesional, më shumë se një vit çregjistrohet nga UISH dhe u nënshtrohet rregullave për ri-regjistrim dhe gjykim profesional për ushtrim profesioni pa Leje. I vendosur në Këshillin Kombëtar me Vendim Nr. 48, datë 15/02/2012.

Neni 47

Profesionistët në pension

1. Profesionet infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie, logopedist/e pensionistë që nuk ushtrojnë profesionin, njihen si anëtarë të Urdhrit të

Infermierit pa qënë të detyruar të paguajnë kuotizacionin e anëtarësisë. Kur ata punësohen (në institucione publike apo private) osë vetpunësohen, detyrohen të paguajnë kuotizacionin e Urdhrit të Infermierit.

2. Profesionet infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie, logopedist/e që nuk ushtrojnë profesionin sepse vuajnë nga një sëmundje invalidizuese që nuk pajtohet me kushtet që kërkon ushtrimi i profesionit dhe/ose e bën të rrezikshëm për popullatën, mbeten anëtarë të Urdhrit të Infermierit si pensionistët.

Neni 48

Ndërprerja e anëtarësimit

1. Anëtarësimi në Urdhër të Infermierit pushon në këto raste:
 - a) Me vdekjen e anëtarit;
 - b) Me heqjen e të drejtës të ushtrimit të profesionit me vendim të formës së prerë nga organet e Urdhrit të Infermierit apo të Gjykatës;
 - c) Kur është duke vuajtur dënimin me heqje lirie;
 - d) Kur nuk plotëson kërkesat e Ligjit, të Kodit Etik-Deontologjik.
 - e) Kur nuk ushtron profesionin 3-5 vjet detyrohet të bëjë një praktikë me mbikëqyrje nga UISH për 3-6 muaj dhe të japë provimin VAP.
 - f) Kur nuk pagan kuotat dhe detyrimet në UISH për më shumë se një vit.
2. Vendimi për çregjistrim i komunikohet zyrtarisht personit dhe institucionit ku ka shërbyer.
3. Vendimi mund t'u bëhet i ditur me një qarkore institucioneve shëndetësore përkatëse, kur gjykohet se paraqet interes publik.
4. Anëtarësimi vazhdon kur anëtari kryen kurse kualifikimi apo specializimi brenda ose jashtë shtetit, duke vënë në dijeni paraprakisht Këshillin Rajonal të Urdhrit të Infermierit.

Neni 49

Të drejtat e anëtarit

Anëtari i Urdhrit të Infermierit ka të drejtë:

- a) Të ushtrojë profesionin në specialitetin e vet në përputhje me legjislacionin në fuqi, me normat e etikës mjekësore dhe Kodin Etik-Deontologjik;
- b) Të kërkojë mbrojtje nga Urdhri i Infermierit për shkeljen e të drejtave të tij profesionale dhe të Etikës e të Kodit nga cilido qoftë;
- c) Të zgjedhë e të zgjidhet në organet e Urdhrit të Infermierit;
- d) Të marrë pjesë në shqyrtimin nga organizmat e Urdhrit të Infermierit për probleme që kanë të bëjnë me të;
- e) Të apelojë vendime të Urdhrit të Infermierit kur i gjykon të padrejta.

Neni 50

Detyrat e anëtarit

Anëtari i Urdhrit të Infermierit ka këto detyra:

- a) Të respektojë ligjet dhe rregullat që lidhen me ushtrimin e profesionit sipas kërkesave të shkencave mjekësore, normave të Kodit Etik- Deontologjik.
- b) Të punojë pa ndërprerje për rritjen e standardeve të tij profesionale dhe të kërkojë që të zbatohen arritjet bashkëkohore në ushtrimin e profesionit prej tij dhe kolegëve.
- c) Të shlyejë në kohë kuotizacionin e anëtarit dhe çdo detyrim tjetër financiar ndaj Urdhrit të Infermierit.

KREU IV

PROCESI ZGJEDHOR PËR KËSHILLAT RAJONAL DHE KOMBËTAR

Neni 51

Caktimi dhe njoftimi i datës së zgjedhjeve

Këshilli Kombëtar cakton datën e zgjedhjeve për Këshillat Rajonalë, Këshillin Kombëtar dhe e njofton atë anëtarëve të paktën 40 ditë përpara zhvillimit të Asamblesë Kombëtare, gjithashtu përcakton numrin e mandateve për Këshillin Rajonalë sipas distrikteve dhe institucioneve si dhe për Këshillin Kombëtar sipas numrit të anëtarëve duke ruajtur gjithëpërfshirjen.

Neni 52

Përbërja dhe detytat e Komisioneve Zgjedhore

Me shpalljen e datës së zgjedhjeve nga Këshilli Kombëtar krijohen Komisionet zgjedhore në nivel rajonal dhe kombëtar.

Pranë tyre krijohen Komisionet për Pranimin e Kandidaturave. Anëtarëve të Komisioneve u ndalohet marrja pjesë në zgjedhje si kandidat në çdo nivel.

Kandidatët për këshilltar sipas mandateve të caktuara, për President, zv. President , sekretar jo më vonë se 10 ditë para Asamblesë. Jo më pak se 5 ditë para Asamblesë shpallen kandidaturat.

Neni 53

Organizimi i zgjedhjeve në faza

Zgjedhjet do të organizohen në tre faza :

Faza I^ë (15 ditë): Zgjedhja e përfaqësuesve të Asamblesë Rajonale

Do të bëhet informimi dhe do zgjidhen përfaqësuesit (delegatët) ose anëtarët e Asamblesë Rajonale nëpër institucione dhe distrikte sipas raportit 1/25 anëtarë të UISH-së.

Çdo përfaqësues i zgjedhur pasi verifikohet në Komisionin e Statutit, Mandatimit dhe Pranimit të Kandidaturave pajiset me mandatin përkatës si anëtarë i Asamblesë Rajonale.

Me organizimin e zgjedhjeve të përfaqësuesve do të merren përfaqësuesit e UISH-së në institucionet e në distriktet përkatëse, anëtarë në Këshillin Rajonal.

Këshilli Rajonal dërgon listën e përbërjes së Asamblesë Rajonale për përgatitjen e mandateve të përfaqësimit për përfaqësuesit (delegatët).

Kandidatët për Këshillin Rajonal, për President, për zv/President dhe Sekretar Rajonal, duhet të depozitojë kërkesën dhe CV-në pranë Këshillit Rajonal/Komisioni i Pranimit të Kandidaturave jo më vonë se dhjetë ditë.

Mandatet për anëtarë të Këshillave Rajonalë, përcaktohen sipas numrit të anëtarëve në distrikte dhe institucione publike dhe private nga Këshilli Kombëtar për të ruajtur përfaqësimin e gjithë anëtarësisë.

Kandidimet e pranuara do shpallen pesë ditë para zgjedhjeve pranë zyrave të UISH-së Rajonale dhe do vendosen në fletët e votimit sipas mandateve të përcaktuara për çdo distrikt ose institucion shëndetësor.

Votimi do të bëhet në Asamblenë Rajonale.

I nisur nga pozicioni i punës si dhe nga mënyra e organizimit të Këshillit Rajonal kandidatët për President Rajonal duhet të jenë nga institucionet shëndetësore të qytetit qëndër qarkut përkatës, pasi do të kryejë detyrën plus detyrës tjetër profesionale dhe krijon mundësinë e kontaktit më të mirë me anëtarësinë.

Komisioni Rajonal i Statutit, Mandatimit dhe Pranimit të Kandidaturave do verifikojë dhe listat e përfaqësuesve për në Asamblenë Rajonale. Të gjitha kandidimet e pranuara shpallen dhe dërgohen në Këshillin Kombëtar në Tiranë dhjetë ditë para zhvillimit të asamblesë për përgatitjen e mandateve të përfaqësuesve si dhe të fletëve të votimit për anëtarë Këshilli apo President.

Faza e II^ë (15 ditë): Zhvillimi i Asambleve Rajonale.

- Asambleja Rajonale zhvillohet në datën e përcaktuar në kalendarin zgjedhor të miratuar nga Këshilli Kombëtar jo më parë se dhjetë ditë nga shpallja e kandidaturave.
- Në fillim të Asamblesë mbahet raporti i Komisionit të Mandateve i cili ka verifikuar ato si dhe kandidaturat e pranuara.

- Mbahet raporti në emër të Këshillit Rajonal mbi veprimtarinë e tij që nga Asambleja e parë nga Presidenti.
- Mbahen raportet e Komisioneve të Punës të Këshillit Rajonal.
- Pyetje diskutime rreth raporteve.
- Zhvillohen zgjedhjet për Këshillin Rajonal.
- Zgjidhet Komisioni i votimit.
- Zhvillohen votimet.
- Shpallen fituesit e Këshillit Rajonal.
- Bëhet mbyllja e Asamblesë.
- Këshilli Rajonal në mbledhjen e parë zgjedh Presidentin, zv/Presidentin dhe emëron Sekretarin e Këshillit. Ndiqet forma e votimit të fshehtë për kandidatët e propozuar dhe pranuar më parë nga Komisioni i Kandidaturave. Fiton ai që fiton 50% + 1 të votave, në rast të kundërt bëhet rivotim midis dy kandidaturave me më shumë vota.

Faza III^ë (10 dhjetë ditë): Asambleja Kombëtare e UISH përbëhet nga tërësia e Këshillave Rajonale dhe Këshilli Kombëtar. Ajo zhvillohet në datën e caktuar kur kanë mbaruar Asambletë Rajonale. Një javë para zhvillimit të saj shpallen kandidaturat për Këshillin Kombëtar (pesë anëtarët) për President dhe për zv/President.

Asambleja zhvillohet me këtë rend dite :

- Lexohet raporti i Komisionit të Mandateve, të Statutit dhe Pranimit të Kandidaturave për të gjithë Këshilltarët Rajonal si dhe për Presidentët e zgjedhur të rajoneve dhe kandidaturat e pranuar për anëtarë Këshilli, për President dhe zv/President.
- Kandidaturat për President, zv/President dhe anëtarë Këshilli duhet të jenë depozituar 10 ditë para , pranë Komisionit të mandateve në Këshillin Kombëtar (dorëzohet një CV dhe vërtetim pune, vlerësimi nga institucioni).
- Komisioni miraton kandidaturat dhe i shpall ato para Asamblesë si dhe përgatit fletët e votimit duke zbatuar me korrektësi kërkesat e Ligjit dhe të Statutit të UISH-së.
- Lexohet raporti në emër të Këshillit Kombëtar nga Presidenti UISH-së mbi veprimtarinë 5 (pesë) vjeçare të UISH-së.
- Mbahen raportet e Komisioneve të Punës të UISH-së.
- Pyetje dhe diskutime.
- Zhvillohen zgjedhjet për pesë anëtarët e Këshillit Kombëtar, kandidaturat e ardhura nga ato qarqe që ka caktuar Këshilli Kombëtar, 2 Tirana, 1 Fieri, 1 Elbasani, 1 Korça (këto janë mandatet).
- Zgjidhet Komisioni i Votimit.
- Zhvillohen votimet për anëtarë Këshilli.
- Shpallen rezultatet.
- Miratohet përbërja e Këshillit Kombëtar **(12 presidentët e qarqeve, 5 anëtarë të zgjedhur nga Asambleja dhe 6 përfaqësues të institucioneve)** sipas ligjit.
- Mbyllet Asambleja.
- Këshilli Kombëtar në mbledhjen e parë zgjedh zv/Presidentin , Presidentin, dhe në mbledhjen e radhës emëron Sekretarin e Përgjithshëm. Ndiqet forma e votimit të fshehtë për kandidatët e propozuar dhe pranuar më parë nga Komisioni i Kandidaturave.

- Shpallet fitues ai që fiton 50+1 të votave. Në rast se nuk ka fitues, përsëritet votimi me dy kandidatura me më shumë vota. Fiton ai që merr shumicën e votave.

Neni 54

Konstituimi i organeve të reja

Presidenti i ri i Këshillit Kombëtar paraqitet në detyrë 10 ditë pas zgjedhjes.

Presidenti në detyrë i Urdhrit të Infermierit i mbaron mandati i tij 40 ditë mbas zhvillimit të Asamblesë dhe zgjedhjes të Presidentit të ri.

Detyra dorëzohet me procesverbal të rregullt dokumentacionin, vulën dhe inventarin material dhe monetar të Urdhrit të Infermierit.

Për një periudhë një mujore, të dorëzimit, do të paguhet të dy presidentët.

KREU V

FINANCAT DHE BUXHETI

Neni 55

Buxheti

1. Urdhri i Infermierit ka buxhetin e vet, të cilin e vet administron në përputhje me rregullat financiare në fuqi.
2. Burimet financiare të Urdhrit të Infermierit janë:
 - a) kuotizacionet e anëtarëve, të miratuara nga Këshilli Kombëtar;
 - b) tarifat e regjistrimit;
 - c) donacione të ndryshme dhe të ardhura të tjera të ligjshme.
3. Të ardhurat që realizon gjatë ushtrimit të veprimtarisë, Urdhri i Infermierit i përdor për të përmbushur misionin e caktuar me këtë ligj.
4. Këshilli Kombëtar miraton buxhetin vjetor, bilancin financiar si dhe pagat e shpërblimet.

Neni 56

Kuotizacionet

Kuotizacioni mujor për anëtarët përcaktohet nga Këshilli Kombëtar çdo fund viti për vitin pasardhës në vartësi të gjendjes, kërkesave dhe nevojave për të siguruar funksionimin normal të Urdhrit të Infermierit.

Shlyerja e kuotizacionit është e detyrueshme dhe kushtëzon anëtarësinë në Urdhrit të Infermierit. Për mosshlyerje për një vit të kuotizacionit, anëtarit i hiqet e drejta individuale për ushtrimin e profesionit.

Neni 57

Përdorimi i burimeve financiare

Burimet financiare të Urdhrit të Infermierit përdoren për:

- a) Paga, honorare, ndihma në rast fatkeqësie për anëtarët dhe familjet e tyre, shpërblime pune dhe kontributin për sigurimet shoqërore të punonjësve;
- b) Shpenzime operative (kancelari, transport, ndërlidhje, energji, dieta, dokumentime fotografike, audiokaseta dhe videokaseta, e të tjera);
- c) Shpenzime për organizim veprimtarish të organizuara nga UISH si dhe veprimtari shkencore, profesionale e kualifikuese (konferenca, simpoziume, sesione, seminare, etj.);
- d) Shpenzime për botime me karakter shkencor dhe informativ për nevojat e anëtarëve;
- e) Blerje mjetesh dhe pajisjesh pune për nevojat e veprimtarisë së Urdhrit të Infermierit;
- f) Shpenzime për pritje e përcjellje delegacionesh e specialistësh nga organizma të ndryshme ndërkombëtare dhe vende të huaja;
- g) Shpenzime për ceremoni të ndryshme për figura të shquara të infermierisë.

Neni 58

Shpërblimet financiare

Pjesëmarrja në mbledhje dhe veprimtari të ndryshme të Këshillave të Urdhrit të Infermierit , të Komisioneve si dhe aktivizimi i ekspertëve për konsulencë, hartim projektesh dhe materialesh të rëndësishme si dhe për shërbime të tjera në funksion të Urdhrit të Infermierit shpërblehen sipas tarifave të miratuara nga Këshilli Kombëtar.

KREU VI

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 59

LLogaria bankare

Urdhëri i Infermierit mban llogari bankare në lekë dhe në valutë të huaj.

Neni 60

Organi periodik

Urdhri i Infermierit nxjerr organin e tij periodik në formën e një Reviste për profesionistët e kujdesit shëndetësor sipas përcaktimit të miratuar nga Këshilli Kombëtar.

Miratuar nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Infermierit me Vendimin Nr.79, datë 26/06/2014.
Ndryshuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar Nr. 122; Datë 09/02/2018;Ndryshuar me
Vendimin e Këshillit Kombëtar Nr. 221 datë 26 /06/2023.

PRESIDENTI UISH

BLERINA DUKA

